



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

Komuna Hani i Elezit
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
07 Nr. _____/10
Hani i Elezit, 10.12.2010

Në bazë nenit 11 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149,nenit 62.3 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 dhe nenit 18 dhe 49.2 të Ligjit për Shëndetësi,Kryetari I Komunës shpall:

K O N K U R S

Për vendet e punës:

– **Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare”Dr.Menduh Kaloshi në Han të Elezit**
– I.Vendi i punës: **Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr.Menduh Kaloshi”**
Numri i ekzekutuesve:një (1).

Drejtori i QKMF-së është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë në punë dhe afarizmin e QKMF-së në punët profesionale të QKMF-së e cila duhet të organizohet dhe të udhëhiqet në pajtim me dispozitat e ligjit, statutit dhe akteve tjera nënligjore;

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi:

- -Në pajtim me politikën shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi të Republikës së Kosovës dhe strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor, drejtori i QKMF-së i propozon për miratim Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale , planin e punës për buxhetin e QKMF-së për vitin vijues ;
- Është përgjegjës për zbatimin e planit të burimeve njerëzore ;
- Nën mbikëqyrjen dhe autorizimin e Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale zbaton buxhetin e QKMF-së;
- Është përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF;
- Zhvillon marrëdhënie të mira me donatorët, OJQ-të dhe me partnerët për zbatimin e tyre;
- Mundëson zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF-së;
- Për punën e tij i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;

Kualifikimi profesional, aftësitë .

- Mjek i Mjekësisë Familjare ose mjek I lëmive tjera
- Licenca e punës
- Tre(3) vite përvojë pune në shëndetësi
- Certifikata mjekësore CM 0102
- Kushtet e dëshiruara
- Përvoja në procesin e implementimit të Mjekësisë Familjare;

-Trajnimet në menaxhmentin shëndetësor dhe shëndetësi publike

Periudha e kontratës:

Tre muaj punë provuese me mundësi vazhdimi deri në 3 vite.

Paga:Koeficienti 9.2

Dokumentacioni i nevojshëm:

-Diploma mbi kualifikimin

-Certifikata e lindjes

-Kopja e letërnjoftimit

-Dëshmi mbi përvojën e punës

-Certifikata që dëshmojnë njohuri nga kompjuteri dhe njohuri tjera.